- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-25-7750-5-1-1/C899

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës për periudhën deri më 16.11.2026 pastaj do të nënshkruhet kontrata .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishte do të jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve në vend punishte janë në përgjegjësi të Operatorit ekonomik deri në shumën e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishte do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishte pra + 30 dite.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim programin për punët brenda 5 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 16.10.2025
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë 16.10.2026
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbajë regjister të punës, dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm.
Inspektimi dhe	22.1	Menaxheri i projektit emrohet nga ZKA.

testimi		Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit neni 3.3 , MASHTI me vendim cakton një zyrtar menaxher për monitorim të projektit nga fillimi deri në përfundim të kontratës
Parapagimi	26.1	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit në baze të Ligjit 08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024 Neni 13 pika 4 nga data e caktuar nga Projekt Menaxheri kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim. Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit. Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës
Mënyra e Pagesave	30.1	Pagesat do të bëhen në bazë të Marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit , e nënshkruar me datë 07.02.2025, protokoli i ministrisë dhe nr. 01/408 protokoli i Komunës nr.02/16 në mes Ministres Arbrie Nagavci dhe Kryetarit të Komunës Qemajl Aliu, neni 3 pika 2 e marrëveshjes, pagesat për këtë projekt bëhen në bazë të realizimit të punimeve sipas kushteve të kontratës , gjithsesi deri në shpenzimin e mjeteve të zotuara të buxhetit të MASHT-ti MASHTI-ti nga buxheti i vitit 2025 financon këtë projekt në vlerë prej 270,000.00 euro, dhe nga buxheti i vitit për 2026 prej 530,000.00 € Pagesat do të bëhen në bazë të situatave (Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës. OE duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit : 1.Garancioni për punët e kryera për(12 muaj) 2.Raporti i pranimi teknik nga komisioni. 3.Situacioni përfundimtar . 4.Fatura e rregullt. 5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamik

Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE, është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhën 12 mujore nga data e pranimit teknik të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme. Nëse me fajin e OE vjen deri te shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje të palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhen mjete nga AK për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegitjen e punimeve që i paguan pune kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale të kontratës në AK.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Të gjitha mosmarrëveshjet do të tentohet që të zgjidhen në mënyrë miqësore nga Përfaqësuesi i Kontraktuesit dhe zyrtarët përgjegjës të Autoritetit Kontraktues, Zyrtari Kryesor Administrativ/Drejtori i Prokurimit.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës..

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

TITULLI I PROJEKTIT: RENOVIMI I GJIMNAZIT "NAIM FRASHERI" NË SHTIME

LOKACIONI: SHTIME

INVESTITORI: KOMUNA E SHTIMËS

VËREJTJE:

- Të gjitha punët duhet të realizohen në përputhshmëri të plotë me standardet EC dhe ISO, si dhe në përputhje të plotë me projektin kryesor, detajet projektuese, përshkrimin teknik dhe kërkesat e organit mbikqyrës. Kontraktuesi obligohet që të lexojë dhe t'i referohet specifikimit teknik, projektin kryesor, detajeve projektuese, paramosës dhe parallogaritës, si dhe të marrë parasysh informacione shtesë gjatë ofertimit financiar dhe kryerjes së punimeve. Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: bletjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, skelat e nevojshme, si dhe dorëzimin e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe duhet të sigurojë lletët e të dhënave teknike dhe mostrat e produkteve për të gjitha materialet që do të përdoren. Për të gjitha punët e kryera duhet të realizohet festimi. Në rast se për shkak të neglizhencës gjatë punës shkaktohen dëme në zonën përreth punështes apo në punishtë, përgjegjësia për riparimin i takon kontraktuesit. Materiali i demtuar që ka ndodhur vlerë konsiderohet pronë e investitorit, i cili do të japë udhëzime për trajtimin e tij. Çmimi për skela dhe skele lifti (platformë lëvizëse) duhet të përfshijet në çdo pozicion ku ato janë të nevojshme për përfundimin e punimeve të parapara. Illogjia e sasive përfundimtare do të behet pas përfundimit të interesit në pozicionin me Liber Nderimor.

- Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramosë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristikat e njëllojta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofrura nga prodhuesit respektiv.

- Në rast se mos përputhjes se të dhënave në mes Paramosës dhe Përshkrimit Teknik, merret parasysh PT, përjashtojë rastet e gabimeve teknike ku duhet të miratohet zgjidhja teknike me e favorshme.

ARKITEKTURA DHE STRUKTURA

POS	PERSHKRIMI PUNËS	NJESIA	SASIA	ÇMIMI PËR SAKTËSI	SUMUA ME TËRHE
1.01.01	Furnizimi dhe montimi i tabelës informuese me të dhënat e projektit, tabela duhet të jetë me dimensione 2.0x3.0m.	copë	1	500.00 €	500.00 €
1.01.02	Rrethimi dhe siguri i punishtes me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjestri informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilit e hekurit dhe llarina.	m'	200	2.00 €	400.00 €
1.01.03	Siguri dhe vendosja e kontejnerit për deponimin e mbeturinave dhe gjësendeve tjera të papërdorura, mbeturinave me pasigji të hadhen në deponi të caktuar nga komuna/qeveria. Pas përfundimit të punimeve, kontejneri së bashku me mbeturinat të largohen nga punishja. Në rast se ka mbeturina me përmbajtje asbesti ose ndonjë material tjetër potencialisht i rrezikshëm duhet të largohet me kujdes duke e pakeluar atë sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ligjet në fuqi dhe me pas të mirret oporovimi nga organet kompetente për deponimin e tij në hapsirë të caktuar sipas AK.	cope	1	500.00 €	500.00 €
1.01.04	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkatshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kanitit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kablnave për nevojat e punëtorëve. Të bëhet kërkesa për kyçe dhe shfrytëzim të rrymës dhe ujit gjatë fazës së ndërtimit. Pas aprovimeve të kyqeve punëkryesi duhet ta merri përsipër punën dhe koston për këtë pozicion.	komplet	1	50.00 €	50.00 €
1.01.05	Punimi i dokumentacionit përfundimtar teknik ("As Build"), sipas specifikimit teknik.	komplet	1	500.00 €	500.00 €
1.01.06	Testimi i materialeve, pajisjeve, strukturat dhe siguri i cilësisë sipas specifikimit teknik.	komplet	1	500.00 €	500.00 €
1.01.07	Shënjestri, përcjellja dhe piktetimi i koordinatave gjeodezike të porteit infrastrukturës sipas shënimeve në projekt deri në përfundim të projektit. Vendoja e koordinatave të llogarit për tërë sipërfaqen e parceles.	m²	5,700	0.10 €	570.00 €
TOTALI (KONTO)					2,060.00 €

POS	PERSHKRIMI PUNËS	NJESIA	SASIA	ÇMIMI PËR SAKTËSI	SUMUA ME TËRHE

1.02.01	Gërmimi me makinë të lëvizshme (dheu) i kategorisë III-IV për hapjen e themeleve të infrastrukturës së ulët (rrugë, parkingje, shëtitore, fusha sportive etj.). Materiali i gërmuar të përdoret për mbushje dhe rrafshim sipas nevojës në pjesën e parterit, ndërsa pjesa e mbetur e materialit të gërmuar duhet të transportohet në depozitë të qytetit. Gërmimi të bëhet sipas kuotave të dhëna nga niveli i gjendjes egzistuese. Sipërfaqet anësore të gërmimit të jenë të rregullta, ndërsa fundi të jetë e niveluar sipas kuotave të dhëna. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punë për mbushjet dhe modelimin e oborrit.	m ³	2,050.00	2.00 €	4,100.00 €
1.02.02	Gërmimi i dheut me dorë për përmirsimin e këndeve dhe nivelizimin e lëvizshëm në vendet ku paraqitet nevoja.	m ³	10.00	4.00 €	40.00 €
1.02.03	Mbushja, shtrirja dhe rrafshimi i lëvizshëm me materialin e gërmuar me parë cilësi ka vetë të mira për mbushje dhe rrafshim të parterit duhet të shtrihet dhe punohet sipas kuotave të projektit dhe sipas nevojës për rrafshim të lëvizshëm. Ngjeshja e materialit të bëhet në shtresa çdo 30 cm deri në arrijen e kompaktësës së duhur. Mbushja bëhet me dhe të mirë për mbjelljen e barit.	m ³	105.00	5.00 €	525.00 €
TOTAL POZICIONI			1.02		4,665.00 €

1.03	PUNËT ZHAVORIT	NJESIA	SASIA	CMIMIZNJESI ME TVSH	SHUMA ME TVSH
P.Q.S	PËRSHKRIMI PUNËVE				
1.03.01	Shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit 63-150 mm për infrastrukturën e ulët (parkingje për automjete, zhavori të shtrihet me trashësi l=45cm. Ngjeshja të realizohet me Mv>50 daN/cm ² . Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	140.00	12.00 €	1,680.00 €
1.03.02	Shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit 0-61mm për të gjithë infrastrukturën e ulët (rrugë, parkingje, shëtitore, fusha sportive etj.), zhavori të shtrihet me trashësi l=20cm. Ngjeshja të realizohet me Mv>50 daN/cm ² . Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	420.00	13.00 €	5,460.00 €
1.03.03	Shtrirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5mm për të gjithë infrastrukturën e ulët (rrugë, parkingje, shëtitore, fusha sportive etj.), zhavori të shtrihet me trashësi l=20cm. Ngjeshja të realizohet me Mv>50 daN/cm ² . Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	420.00	15.00 €	6,300.00 €
1.03.04	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtrësës së gjeotekstilil në tërë sipërfaqet siç është paraparë në projekt (rrugëve, rrugëve me asfalt, parkingut etj.). Gjeotekstili duhet të jetë 315 g/m ² dhe duhet të përbushet të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj material.	m ²	855.00	1.00 €	855.00 €
1.03.05	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rërës 0-8mm për mbrojtjen e gjeotekstilil me trashësi prej (5-7) cm duke paraparë edhe nivelizimin për shtrësat në vazhdim sipas profilin të rërës. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	55.00	15.00 €	825.00 €
1.03.06	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtrësës së imët të rërës me trashësi l-cil shërben për fiksimin e pllakave dhe mbushjen e fagave të tyre. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	15.00	15.00 €	225.00 €
1.03.07	Furnizimi dhe vendosja e kubëzave të betonit me dimensione 60x40x8 cm shtrësa e eperme të jete e punuar nga kuarci me shtrëse mbi 5 mm, kualiteti i kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ 06/2020 Standardi SK EN 1339, soliditeti në lakim dhe kriteret tjera ngjirje shkrije-krypëra, abrazion, Pradhuksi i pllakave të këtë morken CE. Ngjirja e pllakave përzgjedhet nga investitori (Organi Mbikëqyrës).	m ²	720.00	45.00 €	32,400.00 €
1.03.08	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 8/20 kuqillet i kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ 06/2020 Standardi SK EN 1340, soliditeti në lakim, min klasa 2/T, dhe kriteret tjera ngjirje shkrije-krypëra. Në këtë pozicion të kalkulohet dhe laçi me perziqe të rërës dhe çimentos për fiksimin e skajorëve.	m ¹	380.00	12.00 €	4,560.00 €

1.03.09	Furnizimi dhe vendosja e skajorëve 16/24 kualiteti i kërkuar sipas Udhëzimit Administrativ 06/2020 Standardi SK EN 1340, soliditeti në lakim, min klasa 2/T, dhe këtereti tjera ngrije shkrije-krypëra. Në këtë pozicion të kalkulohet dhe: lloji me perzije te reres dhe çimenlos per fiksimin e skajorëve.	m'	300.00	15.00 €	4,500.00 €
1.03.10	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit AB 16 me trashësi t=7 cm. Vërejtje: Para porosit të asfaltit të kërkohej atëherë e nevojshme nga prodhuesi për këtë lloj të asfaltit. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur të masës së asfaltit.	m²	340.00	15.00 €	5,100.00 €
TOTAL POZICIONI			1.03	41,205.00 €	

1.04	PUNËT DEMOLIMI				
POS	PËRSHKRIMI PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMIZNJESI METVSH	SHUMA METVSH
1.04.01	Dëmolimi i perdeve nga plastika ose material tjetër të cilat janë të vendosura në pjesën e brendshme në dilaret të cilat do të ndërrohen. Në çmim duhet të përfshihet gjithashtu kthimi i tyre në vendet fillestare, duke përfshirë elementet shtesë të nevojshme për rimontimin. Çdo material i demtuar gjatë demolitimit mbetet përgjegjësi e punëkryesit, i cili duhet të marrë përsipër dëmin dhe koston e demolitimit.	Komplet	1	1,500.00 €	1,500.00 €
1.04.02	Dëmolimi i vraseve, drasave, dolapve, pritave, ndërpreisve, llupave, ndriqes, Projektorve dhe të gjitha elementeve të cilat mund të pengojnë gjatë punës në muret dhe tavane të parapara që do të ndërrohen. Në çmim duhet të përfshihet gjithashtu kthimi i tyre në vendet fillestare, duke përfshirë elementet shtesë të nevojshme për rimontimin. Çdo material i demtuar gjatë demolitimit mbetet përgjegjësi e punëkryesit, i cili duhet të marrë përsipër dëmin dhe koston e demolitimit.	Komplet	1	1,500.00 €	1,500.00 €
1.04.03	Dëmolimi i mureve ekzistuese nga bllokat. Materiali i demtuar të transportohet në depoti të cilën e cakton organi mbikëqyrës.	m³	32	30.00 €	960.00 €
1.04.04	Dëmolimi i dyshemes egzistuese nga (tercefi, vinyli, parketi, qeramika dhe dysheme tjera) me të gjitha shërbimet deri tek plaka e maskali, demolimi duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos demtohet plaka mbajtëse. Materiali i demtuar të transportohet në depoti të cilën e cakton organi mbikëqyrës.	m²	3,185.00	7.00 €	22,295.00 €
1.04.05	Dëmolimi i largimi i dyerve të brendshme, PVC, Alumini apo ndonjë material tjetër dhe transporti i tyre deri në depoti të aprovuar nga AK.	Cope	70	25.00 €	1,750.00 €
1.04.06	Dëmolimi me kujdes i dilareve mbi dyer në pozicionet e parapara në projekt, nga materiali, PVC, Alumini, Duri apo ndonjë material tjetër dhe transporti i tyre deri në depoti të aprovuar nga AK.	Cope	32	25.00 €	800.00 €
1.04.07	Dëmolimi me kujdes i dilareve në sallën e sportit, PVC, Alumini apo ndonjë material tjetër dhe transporti i tyre deri në depoti të aprovuar nga AK. (Dilaret janë me dimensione 4 copë 5.7X0.7m dhe 4 copë 5.7X2.7m)	Cope	8	150.00 €	1,200.00 €
1.04.08	Dëmolimi i nyjeve sanitare me të gjitha elementet, sanitari, plaka qeramike, instalime, duke përfshirë edhe esthërit në dysheme, deri tek plaka e maskalit, demolimi duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos demtohet plaka mbajtëse. Materiali i demtuar të transportohet në depoti të cilën e cakton organi mbikëqyrës.	m²	110	15.00 €	1,650.00 €
1.04.09	Prejta e mureve, nga betoni i armuar. Prejta duhet të bëhet me kujdes duke mos demtuar elementet e tjera konstruktive dhe poashtu prejta e materialeve duhet të bëhet njëherësh së bashku të të gjitha komponenteve të materialit (beton-hekur). Prejta të bëhet sipas projektit duke ju referuar pjesës grafike. Materiali i demtuar të transportohet në depoti të cilën e cakton organi mbikëqyrës. Prejta duhet të jete e "pastër" kendet të jene në këndin 90 shkallë.	m'	15	50.00 €	750.00 €
1.04.10	Dëmolimi me kujdes i llumarines së kulmit të Salles. Materiali i demtuar të transportohet në depoti të cilën e cakton organi mbikëqyrës.	m²	330	25.00 €	8,250.00 €
TOTAL POZICIONI			1.04	40,655.00 €	

1.05	PUNËT MURATIMIT				
POS	PËRSHKRIMI PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMIZNJESI METVSH	SHUMA METVSH

1.05.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giler G5 të lidhura me llaq të fliuar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtrëngim. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas llojit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale dhe poashtu ankerimi i bllokave të behet me shufra metalike apo "zhileta" në çdo 3 rreshta të bllokave të vendosur. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjilës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Në llogarit hyn edhe skela e nevojshme për muratim.	m ³	40.00	65.00 €	2,600.00 €
1.05.02	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12 cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giler G5 të lidhura me llaq të fliuar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtrëngim. Muratimi të bëhet sipas standarde dhe sipas manuale sipas llojit të blloqeve me fuga horizontale dhe fuga vertikale dhe poashtu ankerimi i bllokave të behet me shufra metalike apo "zhileta" në çdo 3 rreshta të bllokave të vendosur. Muratimi me llaq vazhdues ose ngjilës adekuat sipas prodhuesit dhe manualeve. Në llogarit hyn edhe skela e nevojshme për muratim.	m ³	25.00	65.00 €	1,625.00 €
TOTALI (PUNË)				1205	4,225.00 €

POS	PERSHKRIMET E PUNËVE	NRISIA	SASIA	CALCULUESI METRAZH	SHUMA ME TASH
1.06.01	Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për largimin e lagështisë në muret e kështjës dhe korridorit, fëmijëve dhe elemente tjera strukturore ku është prezente lagështia. Këto aparatura shërbejnë për largimin e lagështisë dhe vendosja e tyre duhet të bëhet në drejtim të mureve të lagura dhe poashtu vendi ku qëndron pasqja duhet të jenë të mbyllura dritare dhe dritare si dhe hapësira me të mëdha duhet të mbyllet në mënyrë që aparatura të funksionojë sa më mirë p.sh. klase apo koridore. Aparati duhet të jetë në punë deri në momentin që e largon lagështinë totale nga muret dhe elementet tjera.	komplet	5.00	500.00 €	2,500.00 €
1.06.02	Gryerja e gjetit dhe bojës deri në nivelin e suvasë ekzistuese në hapësira sipas projektit; në sipërfaqet e mureve dhe tavaneve. Ky proces fillon me identifikimin e zonave të dëmtuara për të përcaktuar shtrirjen e lagështisë dhe nivelin e dëmtimit të shtrësive të muar. Gryerja kryhet manualisht ose mekanikisht, duke përdorur mjete të përshtrësitë si shpatulla ose makinë elektrike, me qëllim heqjen e plotë të shtrësive të dëmtuara. Pas kësaj, zona e trajtuar pasirohet nga pluhuri dhe mbetjet për të siguruar një bazë të pastër për përpunimin e mëtejshëm. Gjithashtu, gjatë kësaj procesi, duhet të sigurohet një lidhje e mirë me shtrësën ekzistuese të gjetit që nuk është dëmtuar, për të garantuar një sipërfaqe të qëndrueshme dhe uniforme.	m ²	6,965.00	10.00 €	69,650.00 €
1.06.03	Furnizimi me material dhe ripatimi i mureve dhe tavaneve të dëmtuara fillon me identifikimin e zonave me probleme, siç janë sipërfaqet e fryra, të plasuritura, të lagështa ose të dëmtuara në mënyrë të ndryshme. Pas evidentimit të dëmtimeve, kryhet heqja e shtrësive ekzistuese, përfshirë bojën, polikolorin dhe gjetin, duke përdorur shpatull metalike, deri në arrijen e shtrësive të suvalimit. Pas përfundimit të kësaj procesi, sipërfaqja pasirohet plotësisht për të larguar pluhurin dhe mbetjet e tjera të lirishtme. Më pas, realizohet ripatimi i suvasë së dëmtuar duke e rrafshuar me ngjilës përzierje me bazë gëlqëre me dy shtrësa dhe një shtrëse rrejt me fije qelqi për përfortimin e llaqit. Pastë të jetë aplikuar kjo shtrësë, sipërfaqja tjetër të llogaritet plotësisht.	m ²	1,850.00	11.00 €	20,350.00 €
1.06.04	Furnizimi me material dhe palinimi i mureve dhe tavaneve me dy shtrësa gjet-masë, në të gjithë hapësirat e parapara në projekt, materiali i përdorur mund të jetë Knaut Rolband ose i ngjajshëm në të gjitha këtinat e objektit të përcaktuar në projekt.	m ²	6,965.00	10.00 €	69,650.00 €
TOTALI (PUNË)				1205	1,214,800.00 €

POS	PERSHKRIMET E PUNËVE	NRISIA	SASIA	CALCULUESI METRAZH	SHUMA ME TASH
1.07	PUNËT E SHPËRTHYETSHMË				

1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe tavaneve të poliuara me dy shtresa ngjyrë (polikolor) dhe me bazë poliuretani me aftësi të madhe të pastërimit në kthinat e parapara sipas projektit. Para ngjyrosjes duhet të bëhet frëgjimi adekuat i sipërfaqes me lyejje bazë/primer për enlietier për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjijës, etj.	m ²	6,965.00	5.00 €	34,825.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e perimetrit të mureve në një lartësi prej 120cm, me ngjyrë yndytore në dy shtresa. Para ngjyrosjes duhet të bëhet frëgjimi adekuat i sipërfaqes me lyejje bazë/primer për enlietier për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjijës, etj.	m ²	1,450.00	5.00 €	7,250.00 €
1.07.03	Furnizimi me materiale dhe punimi i mureve nga epoksidi Mapelloor Decor 700 ose të ngjashëm, për hapësirat: bajovë, zhveshtore, sipas specifikimeve dhe referencave në projektin grafik. Punimet përfshijnë furnizimin me materiale dhe realizimin e mureve epoksidi me sistemin e plotë të shtresave të përcaktuara. Sistemi i dyshemesë epoksidi duhet të përbëhet nga: - Shtresa bazë: Aplikimi i Primer SN, i spërkatur lehtë me rërë kuarc të thatë (fraksion 0.5 mm), për të përmirësuar ngjijten me shtresat pasuese; - Shtresa e parë: Aplikimi me shpatull i Mapelloor Decor 700 si shtresë e parë; - Procesi i lëmimit: Pas ngurtësimit të shtresës së parë (jo më vonë se 24 orë nga aplikimi), e gjithë sipërfaqja duhet të lëmohej me kujdes duke përdorur pajisje të përshtatshme dhe letër gërmese gradimi 100 ose 120, për të përgatitur sipërfaqen për shtresën pasuese; - Shtresa e dytë: Aplikimi i shtresës së dytë të Mapelloor Decor 700, e ndjekur sërish nga lëmimi i kujdesshëm i sipërfaqes me letër gërmese të njëjtë (gradimi 100 ose 120), jo më vonë se 24 orë nga aplikimi; - Shtresa përfundimtare: Aplikimi i Mapelloor Finish 59W në dy shtresa, për të siguruar mbrojtje shtesë ndaj konsumit dhe një përfundim estetik uniform. Të gjitha materialet, përfshirë Mapelloor Decor 700 dhe Mapelloor Finish 59W, duhet të jenë në të njëjtën nuançë RAL, të përcaktuara në dokumentacionin projektues. Zbatimi duhet të realizohet në përputhje të plotë me udhëzimet teknike të prodhuesit dhe projektin grafik, duke siguruar cilësi të lartë të përfundimit dhe qëndrueshmëri afatgjatë në përdorim.	m ²	445.00	55.00 €	24,475.00 €
TOTALIZIMI				107	66,550.00 €

POS	POS	NUMERI	TRAJTA	SHUMËSITETI	SHUMËSITETI
POS	POS	NUMERI	TRAJTA	SHUMËSITETI	SHUMËSITETI
1.08.01	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në kthinat e parapara në projekt, duke përfshirë shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në dalje për pengimin e përçarjes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi me shtresat në vijim: • Estrihë armuar me fibra plastike t=6 deri 10 cm • Folie P.E. t=150 micron	m ²	3,185.00	10.00 €	31,850.00 €
1.08.02	Furnizimi me material dhe vendosja e termoizollimit në dyshemenë e parapara për shirimit me estrihë e objektit sipas udhëzimeve në projekt dhe përfshirimit teknik. • Termoizollim XPS® t=2 cm • Termoizollim XPS® t=3 cm	m ²	3,185.00	10.00 €	31,850.00 €

1.08.03	Furnizimi me materiale dhe punimi i dyshemes nga epoksidi Mapefloor Comfort AR ose të ngjashëm, për hapësirat: Koridoreve, sipas specifikimeve dhe referencave në projektin grafik. Punimet përfshijnë furnizimin me materiale dhe realizimin e dyshemesë epoksida me sistemin e plotë të shtrësave të përcaktuara. Sistemi i dyshemesë epoksida duhet të përbëhet nga: - Shtrësa bazë (primer): Aplikimi i Primer SN, i cili shërben si bazë ngjitëse, i spërkatur lehtësisht me rërë kuarc të thatë (fraksion 0.5 mm) për të krijuar sipërfaqe me velli më të mirë ngjitëse. - Shtrësa e gomës amortizuese: Vendoja e Mapecomfort FL me trashësi 4 mm, e liksuar me Mapefloor Pore Filler, për të siguruar rehëti dhe reduktim të zhurmës në hapësirat e ndjeshme. - Mbushja e poreve: Mbushja e poreve të Mapecomfort FL me Mapefloor Pore Filler për të përgatitur sipërfaqen për shtrësat pasuese. - Shtrësa poluretane: Aplikimi i Mapefloor PU 460 në trashësi mesatare prej 2 mm, e cila siguron qëndrueshmëri mekanike dhe rezistencë të lartë kimike. - Shtrësa përfundimtare: Aplikimi i Mapefloor Finish 59W në dy shtrësa, për të siguruar përfundim estetik dhe mbrojtje shtesë ndaj konsumit. Të gjitha produktet Mapefloor PU 460 dhe Mapefloor Finish 59W duhet të jenë në të njëjtën nuancë RAL, sipas përcaktimit në dokumentacionin projektues. Zbatimi i sistemit duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet teknike të prodhuesit dhe sipas projektit grafik, duke siguruar cilësi të lartë të zbatimit dhe jetëgjatësi në përdorim.	m ²	515.00	55.00 €	28,325.00 €
1.08.03	Furnizimi me materiale dhe punimi i dyshemes nga epoksidi Mapefloor Comfort AR ose të ngjashëm, për hapësirat: Klasë, depo, shkollë, hapësira e kalldores, sipas specifikimeve dhe referencave në projektin grafik. Punimet përfshijnë furnizimin me materiale dhe realizimin e dyshemesë epoksida me sistemin e plotë të shtrësave të përcaktuara. Sistemi i dyshemesë epoksida duhet të përbëhet nga: - Shtrësa bazë (primer): Aplikimi i Primer SN, i cili shërben si bazë ngjitëse, i spërkatur lehtësisht me rërë kuarc të thatë (fraksion 0.5 mm) për të krijuar sipërfaqe me velli më të mirë ngjitëse. - Shtrësa poluretane: Aplikimi i Mapefloor PU 460 në trashësi mesatare prej 2 mm, e cila siguron qëndrueshmëri mekanike dhe rezistencë të lartë kimike. - Shtrësa përfundimtare: Aplikimi i Mapefloor Finish 59W në dy shtrësa, për të siguruar përfundim estetik dhe mbrojtje shtesë ndaj konsumit. Vërejtje: Në hapësirën e shkollës duhet të parashihet përdorimi i këndeve metalike mbrojtëse, të domosdoshme për zbatimin korrekt të shtrësës së epoksidit si në pjesën ballëre të shkollës, ashtu edhe në sipërfaqet mbajtëse (shkallëset). Këto elemente sigurojnë një përfundim të qëndrueshëm, estetik dhe të mbrojtur nga dëmtimet gjatë përdorimit. Të gjitha produktet Mapefloor PU 460 dhe Mapefloor Finish 59W duhet të jenë në të njëjtën nuancë RAL, sipas përcaktimit në dokumentacionin projektues. Zbatimi i sistemit duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet teknike të prodhuesit dhe sipas projektit grafik, duke siguruar cilësi të lartë të zbatimit dhe jetëgjatësi në përdorim.	m ²	1,180.00	55.00 €	64,900.00 €
1.08.04	Furnizimi, transporti, dhe punimi i Dyshemesë Sportive me Poliuteron PU 12 mm-ne tre shtrësa për sallë të brendshme. Shtrësa bazë: amortizuese duhet të jetë 10 mm dhe e përpunuar nga granule gome SBR (1-3.5 mm) e përzier me 20 % PU Binder. Mbushja e poreve bëhet me 1.8 Kg/m² Poliuteron si dhe shtrësa e sipërme me PU vatenivëlizues 2-2.2 Kg/m², ndërsa shtrësa përfundimtare 2 mm Poliuteron 0.15 Kg/m². Ky material ka afërsisht të njëjtë zakonshme: amortizuese dhe instalimi bëhet me paver.	m ²	300.00	65.00 €	19,500.00 €

TOTALI PËR ZONIN 1.08 28,325.00 €

POS	PËRSHKRIMI PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/ANËSI ME VSH	SHUMA ME VSH
1.09.01	Furnizimi me material dhe vendosja e hidroizolimit i frohet Planiseal 288 në kllinat banjot. Në çmim duhet përfshirë hidroizolinin e dysthemesë në këto hapësira si dhe hidroizolinin e mureve perimetrike me lartësi si ne projekt me hidroizolin të lëngshëm fleksibil dykomponentësh të aplikuar min. dy shtresa sipas udhëzimeve të prodhuesit. Poashtu në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të polisterit ose rrejtave me fije qelqi në kënde për të penguar plasatjen e hidroizolimit si dhe shtimi paraprak i të melave të sipërfaqes. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe atalet e përçaktuara nga prodhuesi. Në të gjithë perimetrin e kllinave duhet bërë ngjitja e izolimit min.30 cm. tek pjesa e duashve duhet të jetë në lartësi min. 240cm si dhe tek pjesa e nyjeve shtilare dhe lavamanëve të behet izolimi në lartësin min.120cm	m ²	275.00	4.00 €	1,100.00 €
1.09.02	Furnizimi me material dhe vendosja e hidroizolimit në perimetrin e mureve të shkollës, në nivelin e drenazhit. Hidroizolimi është paraparë të vendoset nga niveli i gypit të drenazhit deri në pjesën që del mbi sipërfaqen e tokës, duke u siguruar që të mos dëmtohet fasada ekzistuese e objektit. Në rast të ndonjë dëmtimi gjatë realizimit të punimeve, përgjegjësia për riparimin bie mbi kontraktorin. Materiali i përzgjedhur për zbatimin e hidroizolimit është folia PVC, specifikisht MAPEPLAN UG20 ose të ngjashme me trashësi 2.0 mm, e cila bashkohet në mënyrë të kontrolluar me aparat me ajër të nxehtë. Procesi i punimeve duhet të përfshijë këto faza: Pastirimi i plotë dhe përgatitja e sipërfaqes së betonit për vendosjen e hidroizolimit. Hidroizolimi i shputave dhe pllakave të themellit me folien PVC. Vendosja e një shtrese të gjeolekstit 300 g/m ² nën PVC-në për mbrojtje paraprake. Pas përfundimit të hidroizolimit, vendosja e një shtrese mbrojtëse të gjeolekstit 500 g/m ² . Vërejtje: Hidroizolimi në sipërfaqe horizontale duhet të mbulohet me një shtresë betoni të varfër për mbrojtje të mëtejshme.	m ²	375.00	10.00 €	3,750.00 €
TOTAL PUNËT			650	100	4,850.00 €

POS	PËRSHKRIMI PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/ANËSI ME VSH	SHUMA ME VSH
1.10.01	Punimi dhe veshja e mureve të bodrumit në zonën e hapjes së rampës me fasadë ekrilike të tipit "demit fasadë", në përputhje me pozicionet e përçaktuara në projekt. Fasada do të jetë në ngjyrë të bardhë silikate, me përbërje ekologjike në bazë të qelqit ujor të kaliumit dhe shtresave organike ndihmëse, duke respektuar standardet DIN 18363. Të gjitha punimet për këtë pozicion përfshijnë aplikimin me të gjitha shtresat e nevojshme si më poshtë: Shtresa bazë për fasadë – paralyerje. - Ngjites për fermozolim, - Pllaka stiropor f=12 cm, - Rrjetë fasade me rrjetës (gjerësi rrjete 155 mm), - Masë rrëshuese për përfortim, - Shtresë përfundimtare me suvatë minerale të llojit Edel Putz Extra Riber ose të ngjashme. - Ngjyrë silikate për fasadë "JUB" ose ekuivalente, në të njëjtën nuancë me sipërfaqet ekzistuese të asaj pjese. - Po ashtu, lyerja përfshin të gjithë sipërfaqen e ballit ku bashkohet izolimi termik ekzistues me atë të rin. Përfshihet në çmim edhe: - Vendosja e këndeve të rrjetës për fasadë, - Aksesoret dhe elementet mbajtëse për ankimimin e pllakave të stiroporit, - Montimi dhe çmontimi i skelavë për realizimin e punimeve.	m ²	37.00	30.00 €	1,110.00 €
TOTAL PUNËT			37	30	1,110.00 €

1.11	DITARET				
POS	PËRSHKRIMI/PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESIA ME TVSH	SHUMA ME TVSH
1.11.01	Furnizimi dhe instalimi i dritareve PVC në përpunje me skemat e dritareve dhe detalet e projektit. Para instalimit të dritareve të reja paraprakisht duhet përmirësuar, rregulluar muri rreth perimetrit për t'u instaluar dritaja në mur të fortë pa zbrazëllira. Çmimi për dritare duhet të përfshijë karakteristikat e mëposhtme: • Ngjyra e kornizës e bardhë ose ngjyre tjetër e përcaktuar nga përfiluesi; • Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë, $U_{w\leq 1.4 \text{ W/m}^2\text{K}}$; • Xham i dyfishtë 4+16+4 mm, i mbushur me argon dhe Low "E" katër sezonal. Koeficienti i izolimit të xhamit min. $U_g=1.1 \text{ W/m}^2\text{K}$; • Korniza e profilit min 5 lusha termike dhe së paku b/h=80/80 mm trashësi dhe tre gomina; • Profil i brendshëm strukturorë metalike min=2 mm instaluar brenda kornizës së PVC-së; • Profil shitesë/kornizë nga PVC për mbështetjen e pikorës dhe solobankës; • Mekanizmi mbyllës sipas DIN EN 1627, 1628, 1629, 1630 Siguria Bozë RC 2; • Montimi duhet të bëhet me ankimim dhe bulonë si dhe shkurën montuese nga PU.				
a	POS W1 Dimensionet: 570X70cm	copë	4	2,000.00 €	8,000.00 €
b	POS W2 Dimensionet: 570X270cm	copë	4	5,000.00 €	20,000.00 €
a	POS W1 Dimensionet: 240X65cm	copë	2	900.00 €	1,800.00 €
b	POS W2 Dimensionet: 480X65cm	copë	2	1,500.00 €	3,000.00 €
TOTAL POZICIONI				1.11	32,800.00 €

1.12	DYERT				
POS	PËRSHKRIMI/PUNËVE	NJESIA	SASIA	CMIMI/NJESIA ME TVSH	SHUMA ME TVSH
1.12.01	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerëve të brendshme nga prodhuesit "HORMAN", "NOVOFORM", apo i ngjashëm nga fletët e metallit i plastifikuar. Krahët e derës të jetë me mbështjellës metalik t=0.8mm të mbushura me termoizolim Propem, trashësia e krahut të derës t=4cm. Shkoll/kornizat të jenë metalike t=2.2mm, mveshje e murit (20-30 cm), dhe lartësi sipas dim. në projekt duke përfshirë ndriqimin brenda kornizës si dhe të pajisura me gomë perimetrike, mentesha të pjesës, mekanizmi mbyllës dhe dorezë inox; me izolim akustik të akorduar sipas DIN EN ISO 140-3 (232dB). Shkoll/kornizat dhe paneli i derës me nuanca RAL 9007. Dyeritë në lartësi të hapjes finale 210cm. Të gjitha dyertë dhe materialet e tyre duhet të jenë me standarde të kualitetit sipas ISO 9001.				
a	POS D1 Dimensionet: 100X305cm	copë	23	750.00 €	17,250.00 €
b	POS D2 Dimensionet: 90X305cm	copë	2	750.00 €	1,500.00 €
c	POS D3 Dimensionet: 80X305cm	copë	10	750.00 €	7,500.00 €
d	POS D4 Dimensionet: 110X205cm	copë	1	750.00 €	750.00 €
e	POS D5 Dimensionet: 100X210cm	copë	6	750.00 €	4,500.00 €
b	POS D7 Dimensionet: 80X210cm	copë	1	750.00 €	750.00 €
1.12.02	Furnizimi dhe montimi i dyerve nga alumini sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë të gjitha mjetet e lidhjes dhe fiksimit dhe shkurën montuese. Hapjet behen sipas skemave të dhëna. - Dyerit nga Alumini me ure termike, me gumina dhe aksesore perçellesh, profilat e aluminit me ngjyre Antracid. - Të kompletuhen me bagllamë, dorezë dhe aksesore tjerë për hapje-mbyllje të derës. - Dera duhet të ketë pajisje për mbyllje automallike, me madhësi të rregullueshme 1-6, qendrueshmëri 200 000 cikle e më lartë. - Krahët e derës në pjesën e poshtme të dyertë të cilat nuk kanë prag duhet ta kenë të fiksuar brushen. - Dera duhet të ketë cilindër dhe qelës për mbyllje. - Gjeresia e ramit min. 91mm dhe krahët min. 93 mm. - Izolimi i persosur zhurmash (mbi 47 dB) me tre seri gumlnash speciale (EPDM) - Fiber e perforcuar poliamide (18 mm) për uren termike, ndërprejta termike të onjhet në shkallën min. (Uf= 1.1W/m2K). - Instalimi të bëhet në mënyrë të duhur me ankera dhe bulona.				
a	POS D6 Dimensionet: 160X240cm	copë	2	700.00 €	1,400.00 €
b	POS D6' Dimensionet: 160X240cm	copë	1	700.00 €	700.00 €
1.12.03	Dera Automallike				
a	POS D8 Dimensionet: 300X210cm	copë	1	1,350.00 €	1,350.00 €
1.12.03	Furnizimi dhe montimi i shkallëve paluese për qasje në hapësirën e çatisë, të prodhuara nga dru i trajtuar kundër lagështisë dhe insekteve. Shkallët janë të tipit palues (teleskopik ose segmentar), të integruara në një kapak termoizolues, të montuara në kornizë druri të përforcuar, me gjatësi të përshtatshme sipas lartësisë nga dyshemeja deri në tavani/kulm. Pozicioni përfshin: - Konstruksioni mbyllës i integruar në hapjen ekzistuese të kulmit; - Mekanizmat e palimit dhe lidhjes, - Vidat dhe elementeve për fiksimit të sigurt - Shkopi për hapjen dhe mbylljen e shkallëve, - Izolimi termoizolues i kapakut me trashësi të përshtatshme për të shmangur humbjet termike, - Montimi përfundimtar dhe testimi i funksionalitetit. Të gjitha materialet dhe pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardet evropiane të sigurisë EN 14975 dhe të jenë të certifikuar për përdorim të brendshëm.				
a	POS T1 Dimensionet: 100X100cm	copë	1	350.00 €	350.00 €

TOTAL POZICIONI 1.12 38,050.00 €

1.13	PUNËT E METALIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSIE METVSH	SHUMA METVSH
1.13.01	Furnizimi dhe vendosja e paneleve sandwich PU me trashësi 10cm për izolimin termik dhe strukturor mbi kullm. Këto panele përmbajnë një bërthamë të poliuretanit (PU) të rrethuar nga dy fletë metalike. Përa instalimit të paneleve, duhet të bëhet inspektimi dhe përgatitja e strukturës mbajtëse për të siguruar që është e qëndrueshme dhe e pastër. Kontrolli i nivelit dhe drejtpeshimit të sipërfaqes mbi të cilën do të vendosen panelet është i domosdoshëm për të garantuar instalimin e duhur dhe jetëgjatësinë e strukturës. Karakteristikat dhe Specifikimet Teknike të Paneleve: - Bërthama: Poliuretani (PU) me densitet $40 \pm 2 \text{ kg/m}^3$. - Fletë e Sipërme Metalike: Gjerësia 1250 mm, trashësi 0.3 – 0.50 mm. - Fletë e Poshtme Metalike: Gjerësia 1070 mm, trashësi 0.3 – 0.50 mm. - Trashësia e panelit: 10cm - Veshja me Zink: 100 - 275 gr/m ² , për mbrojtje nga korrozioni. - Shtrësa e Sipërme: 15-20 mikronë; për mbrojtje të jashtme. - Shtrësa Bazë (Primer): 5 mikronë, për ngjijë të mirë. - Shtrësa e Propërme: 5-7 mikronë, për stabilizim të materialit. - Koeficienti i Përçueshmërisë Termike: $\lambda = 0.022 \text{ W/m}^\circ\text{K}$, që ofron izolim termik të shkëlqyer. - Klasa e Rezistencës ndaj Zjarrit: B2/B3, që siguron mbrojtje nga përhapja e zjarrit. - Stabiliteti i Dimensioneve: $\pm 2 \text{ mm}$, për ruajtjen e formës dhe performancës. - Miquësor ndaj Mjedisit: Prodhim i shkëmbyer poliuiretan pa CFC dhe HCFC, duke e bërë atë ekologjik dhe të sigurt për mjedisin.	m ²	330	35.00 €	11,550.00 €
1.13.02	Furnizimi dhe punimi i Porforcimit të kapriçave nga profilit metalike me dimensione:	copë	5	1,000.00 €	5,000.00 €
TOTAL POZICIONI			1.13		16,550.00 €

1.14	PUNËT E PLAFONIT TË LESHUAR				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSIE METVSH	SHUMA METVSH
1.14.01	Furnizimi dhe montimi i tavanit të varur akustik të tipit "THERMATEx® Metall / Kombimetall plain" sipas standardeve EN 14190, në pjesën e banjovës, zhveshloreve. Vija bëhet në distancë sipas projektit me "sistem C" me pllaka të tavanit "THERMATEx® Metall / Kombimetall plain" me trashësi 2.1 cm dhe dimensione 60x60 cm. Profili mbajtës kryesor të plafonit varen me varëse direkte, ose ngjashëm, në hap sipas udhëzimeve të prodhuesit. Profili mbajtës kryesor vendosen në distancë 75-85 cm, ndërsa profilit montuese vendosen në drejtimin e kundërt çdo 33 cm (varësisht nga modeli i pllakave). Fugimi bëhet me materialin Uniflot, vidhosja realizohet me vida SN, dhe liksimi në pjesën e tavanit realizohet me upa metalike.	m ²	120.00	30.00 €	3,600.00 €
TOTAL POZICIONI			1.14		3,600.00 €

1.15	PUNËT E PARTERIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI/NJËSIE METVSH	SHUMA METVSH
1.15.01	Furnizimi me material, kallëpimi dhe betonimi i amfiteatrit të hapur, me trashësi të parajtur si në projektin e strukturës. Betonimi të bëhet me beton të markës C-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	cope	45.00	200.00 €	9,000.00 €
1.15.02	Furnizimi, transporti dhe punimi i armaturës, për pozicionin e strukturave të betonit të armatur në parter, armatura e përdorur për këto pozicione duhet të jetë bërë me profile të ndryshme Ø (8-25) me cilësi B500C, në përputhje me standardet EN dhe delajat e projektit të armimit. Të gjitha shufrat duhet të jenë të pastër, pa pluhur, vaj apo korrozion, dhe nuk duhet të jenë të ndotura, duke siguruar përputhjen e tyre me normal teknike dhe kërkesat për cilësi dhe qëndrueshmëri	kg	4,000.00	1.50 €	6,000.00 €

1.15.03	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L255 cm	cope	5.00	350.00 €	1,750.00 €
1.15.04	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L220 cm	cope	6.00	350.00 €	2,100.00 €
1.15.05	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L200 cm	cope	15.00	300.00 €	4,500.00 €
1.15.06	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L180 cm	cope	28.00	250.00 €	7,000.00 €
1.15.07	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L155 cm	cope	8.00	220.00 €	1,760.00 €
1.15.08	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L 140 cm	cope	1.00	250.00 €	250.00 €
1.15.09	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L120 cm	cope	3.00	250.00 €	750.00 €
1.15.10	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L105 cm	cope	2.00	200.00 €	400.00 €
1.15.11	Furnizimi me material dhe montimi i Mureve te parafabrikuara nga betoni i armuar per portier L 80 cm	cope	2.00	200.00 €	400.00 €
